



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI I MINISTRAVE**

**VENDIM**

**Nr. 472 date 02.07.2011**

**PER**

**DISIPLINIMIN E PERDORIMIT TE FONDEVE BUXHETORE, PER VITIN**  
**2011**

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes, te nenit 16 dhe 40, te ligjit nr.9936, date 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise”, te nenit 10, te ligjit nr.10 355, Date 2.12.2010 “Per buxhetin e vitit 2011”, me propozim te Ministrat te Financave, Keshilli i Ministrave,

**V E N D O S I:**

1. Shpenzimet e personelit, te miratuara ne buxhetin e vitit 2011, per cdo njesi te qeverisjes se pergjithshme, perbejne kufirin maksimal te lejuar per t’u perdorur per cdo njesi shpenzuese, per punonjesit e miratuar me aktet perkatese, ligjore dhe nenligjore. Per disiplinimin e ketyre shpenzimeve per vitin 2011, zbatohen keto masa:
  - a) Cdo funksion ne administraten publike, i miratuar ne organike dhe i paplotesuar ende, te ngrije deri ne ristrukturimin e institucioneve, ne perputhje me standartet e miratuara me vendim te Keshillit te Ministrave. Institucionet qe kane miratuar strukturen pas ketij vendimi apo qe jane krijuar rishtazi ne zbatim te akteve ligjore e nenligjore vazhdojne normalisht plotesimin e vendeve vakante.
  - b) Fondi i vecante i planifikuar te mos perdoret per veprimtari social - kulturore deri me date 1 dhjetor 2011.
  - c) Cdo shperblim i dhene nga fondi i vecante gjate kesaj periudhe per rezultate te mira ne pune, me perjashtim te rasteve kur ligji specifik parashikon ndryshe, te kthehet menjehere ne buxhetin e njesise shpenzuese.

ç) Oret e punes, te kryera mbi kohen normale te punes, per punonjesit e administrates, te konvertohen vetem ne ore/dite pushimi, ndersa per punonjesit, qe marrin pjese ne sherbime operationale dhe, kur nuk eshte i mundur konvertimi i tyre, ne ore/dite pushimi, te konvertohen me pagese, ne perputhje me aktet ne fuqi.

d) Ne buxhetin e vitit 2011 nuk do te lejohet asnje pagese per ditet e pushimit vjetor te pakryer ne vitin 2010. Cdo pagese e kryer per kete qellim te kthehet ne buxhetin e njesise shpenzuese dhe ditet e pushimit vjetor te vitit 2010, te riskedulohen, duke vendosur kryerjen e ketyre pushimeve brenda vitit 2011..

Ngarkohen strukturat perkatese audituese te njesive te qeverisjes se pergjithshme te verifikojne shkeljet e rregullave, sipas pikave "c", "ç", "d", te pikes 1, dhe te nxjerrin aktet perkatese per zhdemtimin e buxhetit dhe marrjen e masave administrative per nepunesin autorizues e zbatues. Brenda tre muajve nga data e daljes se ketij vendimi, drejtorite e auditit te ministrive dhe institucioneve qendrore te raportojne prane Drejtorise se Pergjithshme te Auditit, ne Ministrine e Financave, per zbatimin e masave te mesiperme.

2. Te gjitha fondet buxhetore, qe i nenshtrohen procedurave te prokurimit publik, te cilat deri me date 1 gusht 2011 rezultojne te paprokururara, te bllokohen. Ne kuptim te ketij vendimi, fonde te paprokururara do te vleresohen ato fonde per te cilat deri me 1 gusht, nuk eshte lidhur kontrate. Perjashtohen nga ky rregull fondet buxhetore qe shkojne per sherbimin e ushqimit apo medikamenteve ne ato njesi shpenzuese ne te cilat ekziston ky sherbim, fondet per shpenzime kapitale, te cilat nuk jane objekt prokurimi, financimet e huaja dhe fondet perkatese per kosto lokale dhe detyrime tatimore. Ministri i Financave mund te lejoje vazhdimin e procedurave te prokurimit ne raste teper specifike apo emergjente.
3. Trajnimet jashte vendit per nepunesit e njesive te qeverisjes se pergjithshme, te parashikuara per tu mbuluar me fondet buxhetore te miratuara per vitin 2011, bllokohen.
4. Shpenzimet per udhetim e dieta jashte vendit, per njesite e qeverisjes se pergjithshme, te reduktohen duke perfshire vetem udhetime te rendesise se veçante dhe vetem per nje numer te kufizuar punonjesish. Ne çdo rast, per kryerjen e ketyre udhetimeve te merret miratimi i ministrit/ titullarit te institucionit qendror.

5. Ngarkohen te gjitha institucionet e njesive te qeverisjes se pergjithshme per zbatimin e ketij vendimi

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**SALI BERISHA**